REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

C-IV.-13-1404

Parashtruesi i ankesës:

P M Serbi, *i përfaqësuar nga Projekti për Ndihmë Juridike, rruga e Shkollës 10 500 Graçanicë.*

Kundër

Pala kundërshtare:

Ndërmarrja Shoqërore "BIRRARIA E PEJËS", *e përfaqësuar nga* ***Agjencia Kosovare e Privatizimit****, rr. "Agim Ramadani", Nr. 23, Prishtinë.*

Dhoma e Posaçme e Gjykatës Supreme të Kosovës për çështjet në lidhje me Agjencinë Kosovare të Privatizimit (Dhoma e Posaçme) gjyqtarja Manushe Karaçi më 28 korrik 2021, lëshon këtë:

AKTGJYKIM

I. Ankesa refuzohet si e pabazuar ndërsa vendimi i Autoritetit të Likuidimit PEJ013-0344 i datës 28 qershor 2013 vërtetohet si i drejtë dhe i bazuar në ligj.

II. Në këtë çështje juridike nuk caktohen taksa gjyqësore.

Rrethanat faktike dhe procedurale:

Më 29 korrik 2013 Dhoma e Posaçme e Gjykatës Supreme të Kosovës ka pranuar ankesë nga Parashtruesi i ankesës kundër vendimit të Autoritetit të Likuidimit të AKP-së PEJ013-0344 të datës 28 qershor 2013.

Parashtruesi kërkon nga gjykata që të aprovohet ankesa e tij si e bazuar dhe të pranohet kërkesa për kompensimin e të ardhurave personale në shumë prej 3,200.00 euro për periudhën 01 qershor 1999 deri 31 dhjetor 2000.

Kësaj ankese parashtruesi si provë i ka bashkëngjitur:

- *Kopjen e vendimit të Autoritetit të Likuidimit PEJ013-0344 i datës 28 qershor 2013;*
- *Kopjen e kërkesës për lirim nga pagesa e taksës gjyqësore;*
- *Kopjen e librezës së punës nr. 1069.*

Duke ju referuar vendimit të Autoritetit të Likuidimit nr. PEJ013-0344 të datës 28 qershor 2013 gjykata vëren se Parashtruesi i ankesës më 17 gusht 2007 kishte paraqitur kërkesë të afatshme duke kërkuar dëmshpërblimin për pagat e papaguara në shumë prej 3,200.00 euro nga NSH "BIRRARIA E PEJËS". Me këtë vendim Agjencia Kosovare e Privatizimit e kishte refuzuar kërkesën e parashtruesit si të pavlefshme.

AKP-ja e refuzoi kërkesën si të pavlefshme duke ju referuar Nenit 36.2 nënparagrafi 1 i Shtojcës së Ligjit nr. 04/L-034 për AKP-në i cili parasheh që *"...elementet në vijim përbëjnë bazë të mirë dhe të mjaftueshme sipas këtij ligji për refuzimin e një Kërkese apo interesi të pretenduar të kapitalit apo pronësisë: ...kërkesa apo pretendimi është i pasafatshëm sipas kufizimeve kohore të aplikueshme".*

Në vendimin e kundërshtuar AKP-ja thekson se kërkesa ka të bëjë me pagat e papaguara për periudhën 01 qershor 1999-31 dhjetor 2000. Neni 608 i Ligjit të Punës së Bashkuar (publikuar në Gazetën Zyrtare nr. 53 të vitit 1976), i aplikueshëm sipas Nenit 1 të Rregullores së UNMIK-ut nr. 1999/24, parashikon që 'pagesa e shumës së pagës apo rrogës, apo secilës kërkesë tjetër e punëtorit që rrjedh nga marrëdhënia e punës do të jetë e parashkruar për tre vjet'.

Në bazë të dispozitave të mësipërme kërkesa do të duhej të ishte paraqitur në gjykatë apo ndonjë organ kompetent brenda tri viteve nga momenti kur NSH-ja pretendohet të mos ketë përmbushur obligimet e saj ndaj parashtruesit që rrjedhin nga marrëdhënia e punësimit, pra tre vite nga data 01 qershor 1999.

Në vlerësim të provave të prezantuara gjykata vendos që kërkesën e paditësit për lirim nga pagesa e taksës gjyqësore ta aprovojë si të bazuar dhe në këtë mënyrë lirohet nga pagesa e saj.

Në bazë të Ligjit për Dhomën e Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës, gjyqtari i Dhomës së Posaçme nxjerr një urdhër me të cilin ankesa e dorëzuar nga Parashtruesi i ankesës i dërgohet AKP-së për përgjigje në ankesë.

Më 13 qershor 2014 AKP-ja dorëzon mbrojtjen e saj ndaj ankesës së parashtruesit të dorëzuar më 29 korrik 2013 kundër vendimit të Autoritetit të Likuidimit PEJ013-0344 të datës 28 qershor 2013 të NSH "BIRRARIA E PEJËS".

AKP-ja përmes mbrojtjes së saj kërkon nga Dhoma e Posaçme që të refuzojë ankesën si të papranueshme dhe/ose të pabazuar, dhe të vërtetojë (lë në fuqi) Vendimin e Autoritetit të Likuidimit PEJ013-0344 të datës 28 qershor 2013.

Gjykata për rastin në fjalë merr për bazë provat e parashtruara nga të dyja palët dhe lëshohet në merita të lëndës.

Arsyetimi Ligjor:

Ankesa refuzohet si e pabazuar ndërsa vendimi i Autoritetit të Likuidimit PEJ013-0344 i datës 28 qershor 2013, vërtetohet si i drejtë dhe i bazuar në ligj.

Në bazë të nenit 2.4 dhe nenit 77.1.1.1 të Ligjit Nr. 06-L-086 të Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës për çështjet që lidhen me Agjencinë Kosovare të Privatizimit (në tekstin e mëtejmë Ligji për Dhomën e Posaçme), gjykata zbaton dispozitat procedurale të këtij ligji.

Në kuptim të nenit 76.3 të Ligjit për Dhomën e Posaçme në lidhje me nenin 399 të Ligjit për Procedurën Kontestimore, gjykata vlerëson se faktet që përmban ankesa nuk e vërtetojnë atë dhe merr Aktgjykim pa caktuar seancë dëgjimore.

Neni 42 pika 2 e Ligjit për Dhomën e Posaçme, parasheh se pala që pretendon një fakt apo ngjarje ka barrën e dëshmisë për të dëshmuar vërtetësinë e pretendimit të tillë, duke paraqitur parashtresat apo duke paraqitur provat materiale (të dokumentuara, fizike dhe/ose dëshmuese), ndërsa pika 3 parasheh se pala që pretendon një fakt apo ngjarje ka mundësinë e arsyeshme për të paraqitur apo dorëzuar provat materiale për të mbështetur një pretendim të tillë, nëse pala e tillë dështon që të paraqesë apo dorëzojë provat e tilla, atëherë vlerësohet se pala nuk ka ofruar barrën e dëshmisë lidhur me pretendimin e tillë.

Sipas nenit 7 të Ligjit për Procedurën Kontestimore, palët kanë për detyrë t'i paraqesin të gjitha faktet mbi të cilat i mbështesin kërkesat e veta dhe të propozojnë prova me të cilat konstatohen faktet e tilla. Me fjalë të tjera, kushdo që thotë diçka duhet ta dëshmojë atë (*ei incumbit probatio qui dicit*).

Sipas vendimit të Autoritetit të Likuidimit më 17 gusht 2007 Parashtruesi kishte paraqitur kërkesë të afatshme duke kërkuar dëmshpërblimin për papaguara në shumë prej 3,200.00 euro nga NSH "BIRRARIA E PEJËS".

Rrjedhimisht, parashtruesi do të duhej të kërkonte pagat të cilat nuk ia ka paguar NSH-ja brenda tre viteve nga data 01 qershor 1999, kur parashtruesi nuk pranoi kompensimin për pagat e papaguara.

Një kërkesë e tillë kreditore do të duhej të ishte paraqitur në gjykatë apo ndonjë organ kompetent brenda tri viteve nga momenti kur NSH-ja pretendohet të mos ketë përmbushur obligimet e saj ndaj parashtruesit.

Neni 36.2 nënparagrafi 1 i Shtojcës së Ligjit nr. 04/L-034 për AKP-në parasheh që *"...elementet në vijim përbëjnë bazë të mirë dhe të mjaftueshme sipas këtij ligji për refuzimin e një Kërkese apo interesi të pretenduar të kapitalit apo pronësisë: ...kërkesa apo pretendimi është i pasafatshëm sipas kufizimeve kohore të aplikueshme".*

Sipas Nenit 608 të Ligjit mbi Punën e Bashkuar (publikuar në Gazetën Zyrtare nr. 53 të vitit 1976) i aplikueshëm sipas nenit 1 të Rregullores së UNMIK-ut nr. 1999/24, parashikon se: *'pagesa e shumës së pagës apo rrogës, ose të ndonjë kërkese tjetër të punëtorëve që rrjedh nga marrëdhënia e punës parashkruhet për tre vjet'.*

Për më tepër edhe Neni 137 i Ligjit për Marrëdhëniet e Detyrimeve i vitit 1978 gjithashtu e parasheh afatin e njëjtë kohor për parashkrimin e të gjitha kërkesave me para si rezultat i marrëdhënies së punës.

Në bazë të nenit 31, paragrafi 1 i Ligjit Nr. 06-L-086 për Dhomën e Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës i cili përcakton se: *'Palët, në parashtresat e tyre me shkrim, duhet të paraqesin një pasqyrë gjithëpërfshirëse të fakteve që ato palë i dinë, apo me arsye besojnë të jenë relevante apo materiale për kërkesën, lëndën, procedurën apo rastin përkatës'.*

Me nenin 76 paragrafi 3 i Ligjit Nr. 06-L-086 për Dhomën e Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës parashihet që: *'në interpretimin dhe zbatimin e këtij ligji, kudo që është e nevojshme për të zgjidhur një çështje procedurale që nuk trajtohet mjaftueshëm me këtë ligj, Dhoma e Posaçme do të zbatojë mutatis mutandis dispozita përkatëse të Ligjit mbi Procedurën Kontestimore'.*

Sipas nenit 7, paragrafi 1 i Ligjit për Procedurën Kontestimore parasheh që: *Palët kanë për detyrë të paraqesin të gjitha faktet mbi të cilat i mbështesin kërkesat e veta dhe të propozojnë prova me të cilat konstatohen faktet e tilla.*

Gjykata pasi që bëri vlerësimin e secilës provë veç e veç dhe të gjitha së bashku, arriti në përfundim se në këtë çështje juridiko-civile ankesa është e pabazuar.

Duke pasur parasysh afatin e parashkrimit në bazë të dispozitave të lartcekura ligjore Gjykata ishte e obliguar që padinë e Paditësit ta refuzojë në tërësi si të pabazuar ashtu siç u tha në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Shpenzimet Gjyqësore:

Duke u bazuar në Nenin 62 paragrafi 5 i Ligjit Nr. 06/L-086 për Dhomën e Posaçme të Gjykatës Supreme secila palë i bartë shpenzimet e veta.

Ndaj parashtruesit të ankesës nuk caktohet taksë gjyqësore ngase kërkesa për lirim nga pagesa e taksës gjyqësore është aprovuar sipas Udhëzimit Administrativ të Këshillit Gjyqësor të Kosovës nr. 01/2017 të datës 1 maj 2017 për Unifikimin e Taksave Gjyqësore.

Këshillë Juridike:

Kundër këtij aktgjykimi mund të parashtrohet ankesë me shkrim në Kolegjin e Apelit të Dhomës së Posaçme brenda 15 ditësh nga pranimi i këtij aktgjykimi. Ankesa duhet të dorëzohet në bazë të nenit 9 paragrafi 6 të Ligjit Nr. 06/L-086 për Dhomën e Posaçme të Gjykatës Supreme.

G J Y Q T A R J A,
Manushe Karaçi